

Edukimi për drejtësi shoqërore - Aktivitete për klasë

Qëllimet e programit:

Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit do të:

- Përfordojnë vetë-konceptin e fëmijëve dhe identitetet grupore duke pranuar, respektuar dhe afirmuar të gjitha kulturat dhe përvojat e fëmijëve
- Përfordojnë marrëdhëniet e shkollës me familjet dhe komunitetet duke i inkuadruar në materialin mësimor, si bazë për mësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, që vijnë drejtpërdrejtë nga familjet dhe komunitetet
- Nxisin fëmijët të hulumtojnë dhe kërkojnë zgjidhje për padrejtësitë shoqërore të cilat ata mund t'i hasin.
- Mësojnë si të nxisin të menduarit kritik të fëmijët, rreth keqinterpretimeve, stereotipeve dhe paragjytimeve.
- Jenë me të hapur për të përfshirë grupet e ndryshme etnike gjënjë forma dhe sugjerime se si të lehtësohet ky proces.

Përmbajtja

Shkathtësitë e mësuara në trajnim ndërtohen mbi Standardet Pedagogjike të ISSA për: individualizimin për të vlerësuar diversitetin në mesin e nxënësve dhe familjeve; pjesëmarrjen e familjes; krijimin e ambienteve mësimore gjithëpërfshirëse; hartimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme mësimore që promovojnë bashkëpunimin: hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe planifikimin dhe vlerësimin e mësimnxënies. Programi **Edukimi për Drejtësi shoqërore** do të zgjerojë dhe thellojë njohuritë në këto fusha duke i prezantuar strategjitë për:

- zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetet që tradicionalisht janë të margjinalizuara në sistemin shkollor
- përfshirjen e zërit të fëmijëve dhe familjeve në hartimin e programeve

- promovimin e kapacitetit të nxënësve për bashkëpunim, negociata dhe mendim kritik duke u siguruar nxënësve mundësi për të përfituar përvojë përmes një llojllojshmërie perspektivash dhe duke modeluar respekt për këndvështrime të ndryshme
- zhvillimin e njësive dhe aktiviteteve të integruara që i adresojnë apo inkorporojnë çështjet e drejtësisë shoqërore duke përdorur tema që janë pjesë e kurrikuleve kombëtare, tregime të zakonshme të fëmijëve dhe tema të cilat i iniciojnë fëmijët nga interesat dhe përvojat e tyre (për shembull, drejtësia, përfshirja, bashkëpunimi, si të zgjidhet konflikti dhe ndërprerja e stereotipeve negative); nxënësit gjithashtu mësojnë shkathtësi akademike të përshtatshme për moshën e tyre

Grup i synuar

Ky program i dedikohet të gjithë atyre që punojnë me fëmijët dhe kanë dëshirë t'i njoftojnë fëmijët me dallimet shoqërore

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi prezantohet në formë të trajnimit treditor me gjithsej 24 orë

Certifikimi

Kusht për certifikim është vijueshmëria e plotë e 90% të trajnimit